

18-24 GUSHT JAVA E MBROJTJES





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MBROJTJES


FA NË GADISHMËRI PËR SHUARJEN E ZJARREVE

Edhe gjatë kësaj jave Forcat e Armatosura kanë marrë pjesë me forca dhe mjete në bashkëpunim me Agjensinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për shuarjen e zjarreve në vend, të shkaktuara si pasojë e temperaturave të larta. Të gjitha forcat operationale do të vijojnë të qëndrojnë në gadishmëri për çdo vatër zjarri të mundshme.

JM

★★★★★

mod.gov.al



PËRFUNDON KONKURRIMI NË AKADEMINË E AFA

Akademia e Forcave të Armatosura ka mbyllur procesin e konkurrit për pranimin e maturantëve në vitin akademik 2025-2026 me një numër rekord aplikimesh. Kandidatët kaluan ekzaminimin mjekësor, testimin fizik dhe vlerësimin psikologjik. Rezultatet përfundimtare do të shpallen më 25 gusht.

JM






ANIJA “LISSUS” NIS MISIONIN NË NATO

Anija shqiptare “Lissus” dhe 22 detarë u nisën nga Saranda drejt operacionit të NATO-s “Sea Guardian” në Detin Egje, ku do të shërbejnë për 6 muaj, duke vijuar traditën e suksesshme të Forcës Detare në shpëtimin e jetëve dhe sigurimin e Mesdheut.

JM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES




STËRVITJE E PËRBASHKËT SHQIPËRI-KOSOVË

Efektivët e Qendrës së Zhytjes së Forcës Detare të Shqipërisë zhvilluan në Pashaliman një stërvitje të përbashkët me Forcën e Sigurisë së Kosovës, duke forcuar ndërveprimin dhe kapacitetet për misionet nënujore.

JM



mod.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E MBROJTJES


FORCOHET BASHKËPUNIMI SHQIPËRI-EMIRATET E BASHKUARA ARABE

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Arben Kingji, priti komandantin e Komandës së Bashkuar Operacionale të Emirateve të Bashkuara Arabe, gjeneralmajor Awad Saeed Al-Ahbabi, ku edhe e falënderoi për ndihmën në shuarjen e zjarreve në Shqipëri. Gjeneralmajor Al-Ahbabi shprehu gatishmërinë për të forcuar dhe zgjeruar më tej bashkëpunimin mes dy vendeve.

★★★★★

mod.gov.al

JM



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MBROJTJES

FORCAT E ARMATOSURA, THIRRRJE PËR REKRUTIM

Forcat e Armatosura ftojnë të rinjtë dhe të rejat deri në 29 vjeç të aplikojnë për ushtarë, detarë dhe ajrorë aktivë nga 20 tetori deri më 31 dhjetor 2025, me afatin e dorëzimit të dokumentacionit më 29 gusht 2025. Përveç rekrutimit, ofrohen edhe 60 kuota për Kursin 9-mujor të Përgatitjes së Oficerit në Akademinë Ushtarake, në specialitete si mjekësi, inxhinieri, ndërlidhje, logjistikë dhe këmbësori.

★★★★★

mod.gov.al

JM



ZGJEROHEN HAPËSIRAT E KOMPLEKSIT MUZEAL TË FA

Kompleksi Muzeal i Forcave të Armatosura në Bërzhitë do të zgjerohet me hapësira moderne që lidhin historinë me komunitetin, duke sjellë një rrëfim arkitektonik dhe ambiente funksionale për aktivitetet e përditshme të FA dhe industrisë së mbrojtjes.

JM

